



INFORMATA TË PËRGJITHSHME MBI DEMOKRACINË

FËMIJËT E SË ARDHMES NË DEMOKRACI

LUIZA (10), JON (10), KLOS (10), REDON (10), GAZMEND (11), RIAD (11), URATA (10)



Demokracia është paqe. Ne jetojmë në demokraci, pra kjo do të thotë se ne jetojmë në paqe, prandaj edhe jemi të lumtur

Ne sot u pajtuam që grupin tonë ta emërtojmë „Grupi i Yjeve“.

Grupi ynë, temë diskutimi kemi pasur demokracinë. Demokracia është formë e qeverisjes, me anë të votave të qytetarëve. Pra, populli vendos duke votuar. Kosova është shpallur shtet i pavarur më 17 shkurt në vitin 2008. Që nga kjo datë, ne jemi qytetarë të një shteti të pavarur dhe demokratik. Si të fillë, ne kemi shumë të drejta, duke filluar nga: e drejta e shprehjes së lirë, e drejta e votës, e drejta e shkollimit, e drejta e identitetit etj.

Demokracia i ka disa elemente apo parime: solidaritetin, tolerancën, paqen, respektin dhe barazinë.

Ne mund të solidarizohemi duke iu dhuruar fëmijëve të varfër dhurata. Kështu kemi vepruar ne nxënësit e klasës tonë. Ne atyre u kemi mbledhur rroba dhe ua kemi dërguar. Ne gjithashtu, duhet të jemi tolerant ndaj njerëzve të tjerë dhe t'i respektojmë ata. Nëse e takojmë dikë ndryshe nga ngjyra, raca apo feja jonë nuk duhet ta përqeshim atë.

Demokracia ka lindur në vitin 507 p.e.s. në kryeqytetin e Greqisë, që është Athina. Fjala demokraci rrjedh nga gjuha greke, „demos“ -popull dhe „kratia“ -qeverisje. Në filllet e saj demokracia ka qenë më ndryshe se sot. Atëherë në Athinë, të drejtë vote kanë pasur vetëm

burrat e pasur. Kjo do të thotë se të moshuarit, të varfërit dhe gratë janë lënë anash.

Sot, të gjithë i kanë të drejtat e barabarta, pavarësisht dallimeve fetare, racore ose kombëtare. Kemi dy lloje të demokracisë, e ato janë: demokracia e drejtpërdrejtë dhe përfaqësuese. Në demokracinë e drejtpërdrejtë, populli merr vendime të drejtpërdrejta apo direkte, ndërsa në demokracinë përfaqësuese populli zgjedh përfaqësuesit e vet me anë të votës.

Po ashtu, demokracia përfaqësuese ndahet në sistemin parlamentar dhe presidencial. Në vendin tonë ne kemi demokraci parlamentare, që do të thotë se ne i zgjedhim deputetët, kurse ata e zgjedhin Presidentin e vendit.

Lexues të dashur, porosia jonë është që të gjithë të mësojmë dhe të dhurojmë sa më shumë dashuri e respekt.




Autorët e artikullit



Njëra ndër elementet kyçe të demokracisë është edhe zgjedhja e lirë



Ne kemi shumë të drejta, njëra ndër të cilat është e drejta e shprehjes së mendimit, në forma të ndryshme



Në këtë vizatim tregohet moshë se kur qytetarët mund të votojnë në procesin zgjedhor



Kuvendi, si institucioni më i rëndësishëm i një shteti demokratik



Bashkëpunimi në demokraci është shumë i rëndësishëm



Puna jonë ka vlerë

ZGJEDHJET, FUQIA E POPULLIT

BLEND (10), ELTINA (11), ENGJËLLI (10), JON C. (11), JON D. (10), JONA (11), SHEFQET (10)


Nga ne do të mësoni se sa fuqi ka populli në zgjedhjen e udhëheqësve të tij

Populli i një vendi vendos për përfaqësuesit që do ta udhëheqin vendin në të ardhmen. Ata përfaqësues janë deputetët. Ne i zgjedhim përfaqësuesit kur arrijmë moshën 18 vjeçare, sepse atëherë jemi më të pjekur. Zgjedhja e deputetëve bëhet sipas aftësive të tyre për udhëheqje. Nga deputetët miratohen ligjet e ndryshme si ligjet për arsim, shëndetësi, ekonomi e që luajnë një rol të madh në jetën tonë.


Në Kosovë kemi dy lloje të zgjedhjeve: zgjedhjet qendrore dhe ato lokale. Në zgjedhjet qendrore populli zgjedh deputetët, ndërsa në zgjedhjet lokale populli zgjedh kryetarët e komunave dhe asambleistët. Votimi është i fshehtë, dhe të gjithë qytetarët e Kosovës pa dallim feje, gjinie, race dhe statusi social kanë të drejtën e votës. Pra, vota e secilit ka vlerë të madhe.




Gazetarët e demokracisë



Informacionet tona për zgjedhjet



Elementet e demokracisë




E drejta e votimit



Kandidati për deputet duke e treguar planprogramin e tij

SHTËPIA E POPULLIT - KUVENDI

ALBIOSI (10), ANESA (10), ARDIT (10), ERMIRA (10), ELMEDINI (11), ERIONI (10), OLTİ (10)



Kuvendi është organi më i rëndësishëm dhe ligjvënës në Republikën e Kosovës

Ne, qytetarët e Kosovës e kemi një institucion i cili na mundëson të gjithë neve të jetojmë dhe të trajtohemi në mënyrë të barabartë me njërin-tjetrin. Por, cili është ky institucion dhe si e bën këtë, do të informoheni në vazhdim të këtij artikulli.

Kosova si Republikë ka disa institucione, të cilat kujdesen që vendi ynë të jetë ndër ato vende ku mbizotëron paqja dhe harmonia mes qytetarëve, duke mos



e lënë pas as sigurinë e tyre. Kuvendi është një ndër institucionet që na mundëson neve qytetarëve t'i kemi të gjitha këto që i cekëm më lart. Ndryshe Kuvendin e quajmë „Shtëpia e Popullit“, sepse është populli ai i cili i voton dhe i zgjedh përfaqësuesit, të cilët ndryshe quhen deputetë.

Të drejtën për të kandiduar për deputet e fitojmë kur arrijmë moshën 18 vjeçare, dhe gjithashtu me të fito-

jmë edhe të drejtën për të votuar në procesin zgjedhor. Kuvendi ynë ka gjithsej 120 deputetë, ku 100 prej tyre i përkasin kombit shqiptar. Ndërsa 20 të tjerë i përkasin komuniteteve jo shumicë: komunitetit serb, komunitetit boshnjak, komunitetit romë, komunitetit goran, komunitetit turk, si dhe komunitetit egjiptian. Të gjithë këta deputetë janë përfaqësues dhe zëri i qytetarëve të cilët ua kanë besuar votën.

Kur i përmendëm përfaqësuesit, këtu kuptojmë edhe një ndër funksionet që i ka Kuvendi. Pra, Kuvendi ka funksionin e përfaqësimit të popullit, gjithashtu mbikëqyr Qeverinë, mirëpo funksion më të rëndësishëm ka miratimin e ligjeve.

Ashtu siç e cekëm në fillim, Kuvendi na mundëson të jetojmë në mënyrë të barabartë, e këtë pra e bën me miratimin e ligjeve. Kuvendi i Kosovës punon për të mirën e përbashkët të të gjithë qytetarëve të vet. Ashtu siç është e mangët një botë pa fëmijë, po ashtu edhe një shtet pa Kuvendin nuk mund të jetë i plotë.



Puna në grup



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrur pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Pavarësia“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-2
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë